



SYLLABUS I LËNDËS “E DREJTA NDËRKOMBËTARE PRIVATE”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E DREJTA NDËRKOMBËTARE PRIVATE
Programi:	Juridik i Përgjithshëm
Niveli:	Baçelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III- Semestri VI
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Shefki Shtërbani
Të dhënat kontaktuese:	shefki.shterbani@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda synon tu ofrojë studentëve njohur teorike dhe praktike të Drejtës Ndërkombëtare Private (DNP) ose e njohur tradicionalisht edhe si Konflikti i Ligjeve. Në epokën ku ndërveprimi i personave fizik dhe juridik në marrëdhëniet private dhe tregtare, gjithnjë e më shumë kanë dimension ndërkombëtar, DNP- ja po bëhet një fushë shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme. Këto marrëdhëniet juridiko-private me element të huaj, me një intensitet të lartë në rritje, kërkojnë një kuadër ligjor për të zgjidhur kompleksitetin dhe vështirësitë juridike- private me element ndërkombëtar, kur subjekti është i huaj, objekti i huaj, proceset gjyqësore të huaja, ose interesat juridike të shtetit të huaj.</p> <p>Fillimisht, fokusi i kësaj lënde do të jetë trajtimin e elementit të huaj juridiko- privat; burimet e DNP- së; cilësimin; çështjet paraprake; shmangiet nga normat kompetente. Po ashtu, studentet do të njihen me institucionet dhe karakteristikat dhe konceptet bazë të kësaj lënde, të cilat ndihmojnë në kompetencën e organeve, gjetjen e së drejtës kompetente, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja.</p> <p>Fokusi, i kësaj lënde do të jetë në shqyrtimin teorik dhe praktik të çështjeve të posaçme në lidhje me gjetjen e së drejtës kompetente, duke filluar nga marrëdhëniet statusore me element të huaj si fakt vendimtar (pikë e lidhjes) te personat fizik dhe juridik; marrëdhëniet detyrimore me element të huaj; marrëdhëniet jashtë- kontraktore me element të huaj, deliktet dhe kuazi- deliktet. Gjithashtu, kjo lëndë do të përfshijë edhe procedurën e gjetjes së gjykatës kompetente te marrëdhëniet juridike- private me element të huaj, arbitrazhit ndërkombëtar dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja, në shtetin e vendit.</p> <p>Në fund, sikur në çdo shtet në kuadër të sistemeve juridike në botë, marrëdhëniet juridike- private mund të rregullohen në mënyra të ndryshme edhe sa i përket pozitës së të huajve në shtetin e vendit, specifikisht studentët do të njihen edhe me pozitën e të huajve (personave fizik dhe juridik) në Republikën e Kosovës.</p>

<p>Qëllimi i lëndës:</p>	<p>Kjo lëndë ka për qëllim parësor që të ofrojë njohuri në të kuptuarit teorik dhe praktik duke studiuar në thellësi, në nivel më të avancuar, mënyrat e rregullimit të marrëdhënieve juridike-private me element të huaj, duhet të njihen normat materiale (substanciale) dhe ato kolizive me anën e të cilave rregullohen marrëdhëniet juridike-private me element të huaj, duke marrë parasysh legjislacionin nacional dhe ndërkombëtar, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.</p> <p>Pastaj, njohja me praktikën gjyqësore dhe të arbitrazhit nacional dhe ndërkombëtar, ngase nëpërmjet vendimeve të tyre studentëve do tu ndihmohet që t'i zbatojnë këto parime në mënyrë profesionale dhe kompetente në proceset e brendshme dhe ndërkombëtare të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit:</p>	<p><i>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Të kuptojnë institutet kryesore të DNP-së; -Përcaktojnë dhe zbatojnë rregullat ligjore të zbatueshme kur ka një situatë konflikti ligjor dhe përcaktimin e juridiksionit. -Të demonstrojnë në mënyrë aktive njohuri në fushën e DNP- së si nga perspektiva e BE-së ashtu edhe nga perspektiva e Republikës së Kosovës. -Analizojnë ndikimin e së drejtës ndërkombëtare private nga perspektiva krahasuese dhe ndërkombëtare, dhe në kontekstin e diversitetit social dhe kulturor. - Analizojnë në mënyrë kritike të drejtën dhe kompetencën më të përshtatshme për lëmi të ndryshme brenda DNP- së. -Zbatojnë rregullat e së drejtës ndërkombëtare private për problemet dhe çështjet komplekse, kritikojnë funksionimin e rregullave ndërkombëtare private nga një këndvështrim teorik.

Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	1/15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1/15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/5	5
Ushtrime në terren	5	1	5
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	6	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet ,etj	2	3	6
Totali:			150 orë (6 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Gjatë gjithë semestrit në zhvillimin e kësaj lënde do të përdoren metoda, teknika dhe aktivitete të ndryshme duke zhvilluar mendimin kritik dhe shkathtësi për zgjidhjen e problemeve tek studentët për të arritur qëllimet nxënit të lëndës.</p> <p>Lënda e DNP- së do të mbahet në ligjërata dhe ushtrime, ku do të përfshihen studentët nëpërmjet prezantimeve, punës në grupe, zhvillimit të rasteve simuluese dhe rasteve nga praktika gjyqësore, nga kjo lëmi. Po ashtu studentët do të inkurajohen dhe në punime hulumtuese dhe shkrimin të punimeve seminarike.</p>		
Metodologjia e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> -Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe ushtrime: 10% -Provimi mes-semestral: 10% -Punimet seminarike dhe prezantimet: 10 % -Provimi përfundimtar: 70% 		

Literatura	
Literatura primare:	-Asllan Bilalli, Hajredin Kuçi, & Arbër Ademi, “E Drejta Ndërkombëtare Private (Pjesa e Përgjithshme), Prishtinë, 2021.
Literatura shtesë:	<p>-“Ligj për të Drejtën Ndërkombëtare Private”, Ligji Nr.08/L-028, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 30 / 5 Shtator 2022, Prishtinë.</p> <p>-Daniel Gutmann, “E Drejta Ndërkombëtare Private”, Tiranë, 2009.</p> <p>- Asllan Bilalli & Hajredin Kuçi, “E Drejta ndërkombëtare Private: Pjesa e Posaçme”, Tetovë 2022.</p> <p>- Hajredin Kuçi & Asllan Bilalli, “Kolizioni i Ligjeve: konflikti ndërkombëtar dhe interlokal i ligjeve”,</p> <p>-Bekim Kadriu, E Drejta Ndërkombëtare Private, Tetovë, 2015.</p> <p>-Brussels Ibis Regulation, Regulation (EU) No 1215/2012 of the European Parliament and of the Council of 12 December 2012 on jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in civil and commercial matters.</p> <p>-Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards, New York, 1958.</p> <p>- Brussels Council Regulation (EC) No 2201/2003 of 27 November 2003 concerning jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in matrimonial matters and the matters of parental responsibility.</p> <p>-Rome I, Regulation (EC) No 593/2008 of the European Parliament and of the Council of 17 June 2008 on the law applicable to contractual obligations.</p> <p>-Rome II, Regulation (EC) No 864/2007 of the European Parliament and of the Council of 11 July 2007 on the law applicable to non-contractual obligations.</p> <p>- Edited by Jürgen Basedow, <i>Encyclopedia of Private International Law</i>, Edward Elgar Publishing limited, Publication Date: 2017.</p> <p>-Geert Van Claster, <i>European Private International Law</i>, Oxford University Press, 2016.</p> <p>-Adrian Briggs, <i>The Conflict of Laws</i>, Third Edition, 2013. C.M.V. Clarkson & Jonathan Hill, <i>The Conflict of Laws</i>, Fourth Edition, Oxford University, 2011.</p> <p>-Stefania Bariatti, “Cases and Materials on EU Private International Law”, Bloomsbury Academic 2011.</p> <p>-Gilles Cuniberti, <i>Conflict of Laws: A Comparative Approach – Text and Cases</i>, Edward Elgar Publishing limited, second edition, 2022.</p> <p>Christa Jessel-Holst at. al. “Komentari i Ligjit “Për të Drejtën Ndërkombëtare Private” Nr. 10 428, DT. 02.06.2011, Tiranë 2018.</p> <p>-Ardian Kalia, “E drejta ndërkombëtare private”. Tiranë, 2014.</p> <p>-“Compendium of European Union Legislation on Judicial Cooperation in Civil and Commercial Matters”, 2018 Edition, European Union, 2019.</p>

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
Java e parë:	Hyrje në të Drejtën Ndërkombëtare Private - Përmbajtja; - Metodologjia e Mësimdhënies; - Metodat e Vlerësimit.	Hyrje Prezantim për metodologjinë mbajtjes së ushtrimeve; Metodat e vlerësimit në ushtrime.
Java e dytë:	Zhvillimi historik i DNP- së	Lindja dhe zhvillimi historik i DNP-së.
Java e tretë:	Burimet e DNP- së DNP- ja si degë e së drejtës	Burimet sipas legjislacionit për DNP- së- shembuj Diskutime dhe shembuj nga shfaqja e elementit të huaj juridiko- privat dhe mënyrat e shfaqjes së tij.
Java e katërt:	Institutet kryesore dhe specifikat e DNP- së Marrëdhëniet juridike me element të huaj juridiko- privat dhe mënyrat e shfaqjes së tij	Prezantimi dhe puna në grupe duke trajtuar shembuj konkret nga mënyrat e paraqitjes së elementit të huaj.
Java e pestë:	E drejta kompetente: pjesa e përgjithshme	Raste simuluese. Prezantimi i studentëve. Stuhi mendimesh "brainstorming".
Java e gjashtë:	Subjektet e së drejtës	Prezentim nga studentët për marrëdhëniet statusore për personat juridik.

	Marrëdhëniet statusore me element të huaj për personat juridike: pozita e subjekteve të huaja juridike	<i>Shqyrtimi i legjislacionit të RKS.</i>
<i>Java e shtatë:</i>	TESTI MES-SEMESTRAL	
<i>Java e tetë:</i>	Marrëdhëniet statusore me element të huaj për personat fizik	<i>Raste studimi lidhur me marrëdhëniet statusore për personat fizik. Prezantimi i punës hulumtuese për student për marrëdhënie të caktuara dhe konkrete të personat fizik.</i>
<i>Java e nëntë:</i>	Marrëdhëniet detyimore me element të huaj	<i>Raste studimi për marrëdhëniet detyimore me element të huaj Puna në grupe me studentë.</i>
<i>Java e dhjetë:</i>	Marrëdhëniet jo- detyimore, deliktet, kuazi-deliktet	<i>Prezantim dhe paraqitje e shembujve nga marrëdhëniet jo-detyimore.</i>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Kompetenca ndërkombëtare e gjykatave dhe procedura	<i>Raste studimi nga gjykatat. Puna në grupe në zgjidhjen e rasteve simuluese për gjetjen kompetencën e gjykatës.</i>

<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Kompetenca ndërkombëtare e arbitrazhit tregtar ndërkombëtar	<i>Raste studimi nga arbitrazhet ndërkombëtare. Puna në grupe në zgjidhjen e rasteve simuluese për gjetjen kompetencën e gjykatës.</i>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Njohja dhe ekzekutimi (procedura) i vendimeve të huaja gjyqësore	<i>Prezantim dhe hulumtim i legjislacionit lidhur me procedurën e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja. Shembuj dhe raste gjyqësore të rasteve praktike të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore.</i>
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Pozita juridike e të huajve: në veçanti në Republikën e Kosovës	<i>Hulumtim dhe prezantim nga studentët duke paraqitur pozitën juridike të huajve në RKS. Krahasimi me vende të tjera.</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përmbledhje dhe përgatitje për provimin final.	

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

- Studentet duhet të kenë vijueshmëri të rregullt në ligjërata dhe ushtrime ku do të evidentohet prezenca e tyre në ligjërata dhe ushtrime.
- Studentët janë të inkurajuar fuqimisht për të bërë pyetje, komente dhe të marrin pjesë aktive në diskutime ne ligjërata dhe ushtrime;
- Kopjimi punës se të tjerëve, përdorimi i materialeve të pa miratuara gjatë provimeve, konsiderohet mashtrim dhe nuk do të tolerohet;
- Përdorimi i Lap-top lejohet vetëm kur miratohen nga profesori;
- Përdorimi i telefonit celularë është i ndaluar.